



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 372/2010

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur më 11.12.2010, mori këtë:

### V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3750 (tremijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

Subjekti politik AKR, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku më datë 9 dhjetor 2010 në Prishtinë, gjate fushatës anëtarët e këtij subjekti kanë mbuluar posterin e kandidatës të subjektit politik AKR, Sevdije Lala me posterin e kandidatit të tyre për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Blerim Grainca, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a)..

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga subjekti politik AKR të cilës ia kanë bashkangjitur dhjetë fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posterët e kandidatit Blerim Grainca, nga radhët e subjektit politik AAK, janë vendosur mbi posterin e subjektit politik AKR.

**Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar për të sqaruar se a ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

### Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetë mijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

*Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës Blerim Grainca nga radhët e subjektit politik AAK, janë vendosur mbi posterat e subjektit politik AKR. PZAP-i vlerëson se subjekti politik AAK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 372/2010 më datën 11.12.2010

